

Prindërit dhe roli i tyre në mbrojtjen e fëmijëve nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm



Broshurë informative
për prindërit

Parathënie

Kombi shqiptar ka ekzistuar historikisht bazuar në vlerat e tolerancës dhe bashkëjetesës harmonike fetare. Vizioni ynë i përbashkët sot është ai i një shoqërie që mbështetet në respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, shtetin e së drejtës, barazinë dhe dinjitetin njerëzor. Paqja, stabiliteti dhe begatia në rajonin tonë janë, po ashtu, me rëndësi strategjike për Shqipërinë. Është në interesin e Shqipërisë që të nxisë marrëdhënie të mira me fqinjët, mbi bazën e besimit të ndërsjellë dhe përfshirjes, të cilat mbizotërohen nga harmonia ndëretnike dhe ndërfetare¹.

Gjatë dekadës së fundit, kuptimi mbi mënyrën, format dhe arsyet se pse individët angazhohen në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm, kanë evoluar në përshtatje me vendin, kohën, faktorët e jashtëm dhe të brendshëm. Në të njëjtën mënyrë kanë evoluar dhe mjetet dhe përgjigjet parandaluese ndaj këtyre kërcënimeve. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve të reja, me vendimin e K.M. Nr. 930, datë 18.11.2015 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”, Qeveria shqiptare e konsideron luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm një prej përparësive themelore të programit të saj politik, si dhe parashton angazhimin e saj për ruajtjen e vlerave të tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracinë, si dhe mbrojtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është institucioni kryesor publik në luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm që vepron nën varësinë e Kryeministrit të

1. Bazuar në Strategjinë Kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm

Shqipërisë, e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 13.12.2017. Misioni i Qendrës është harmonizimi dhe koordinimi i përpjekjeve të aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe jo shtetërorë, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm kundër ekstremizmit të dhunshëm. Qendra udhëheq përpjekjet për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit, një dokument shumë i rëndësishëm, që organizon punën për zbatimin e Strategjisë.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve, Save the Children, në bashkëpunim me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri dhe me mbështetjen financiare të UNICEF në Shqipëri do të zbatojnë projektin “Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në shkolla dhe komunitete si mjet për garantimin e të drejtave të fëmijëve”. Ky projekt synon forcimin e kapaciteteve të stafit shkollor dhe autoriteteve arsimore për të mbështetur riintegrimin e fëmijëve dhe të rinjve të kthyer nga zonat e konflikteve.

Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve janë thelbësore për të mbajtur fëmijët të sigurtë dhe të mbrojtur. Ato gjithashtu ndihmojnë në zhvillimin e tyre shoqëror dhe mbarëvajtjen e procesit edukativ dhe mësimor.

Kjo broshurë përmban informacionin e nevojshëm për të ndihmuar prindërit të mbajnë fëmijët e tyre të sigurtë ndaj rreziqeve që vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Gjithashtu ajo tregon se ku duhet të mbështeten për të përballuar problemet dhe shqetësimet që lidhen me këto fenomene.



● Kapitulli I

Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm është një e drejtë.

Shkolla duhet të jetë një mjedis demokratik dhe miqësor, një mjedis i sigurt për nxënësit dhe punonjësit arsimorë.

Ky mjedis duhet të jetë tërheqës dhe bashkëpunues i afërt me prindërit dhe komunitetin për të promovuar arritjet e nxënësve në çdo fushë, për t'i nxitur ata drejt suksesit dhe mbi të gjitha për t'i bërë ata qytetarë të denjë të botës.

Prindërit dhe mësuesit duhet të punojnë së bashku me synimin që të gjithë fëmijët të ndihen të lirë që të zgjidhin problemet e tyre; të mendojnë në mënyrë të pavarur; të njohin dhe të vlerësojnë parimet themelore demokratike; të respektojnë diversitetin e njëri-tjetrit në aspektet fizike, shpirtërore, materiale, intelektuale etj.

Prindërit duhet të bashkëpunojnë me shkollën për të parandaluar sjelljet e ndryshme ekstremiste, bullizmin, dhunën etj. Po ashtu, ata duhet të bashkëpunojnë për të promovuar vlerat pozitive të tolerancës dhe diversitetit për t'i bërë nxënësit të aftë të besojnë në një shoqëri demokratike, në një shoqëri të paqes, të kuptimit të tjetrit, të komunikimit pa gjuhë urrejtjeje dhe diskriminim.



Shpjegim termash

Dhunë - “Të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtitimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjesisë, besimit, apo forcës” (sipas OBSH-së).

Dhunë – përfshin, por nuk kufizohet vetëm në veprat apo veprimet e qëllimshme që një person kryen ndaj personit tjetër, si: përdorimi i forcës fizike, presioni psikik, çdo veprim që shkakton apo rrezikon dhembjen fizike dhe psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës; cenimi i dinjitetit personal; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër; vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.

Ekstremizmi² - Në kuptimin e gjerë të fjalës, “ekstremizmi” nënkupton “besimin dhe mbështetjen për idetë që janë shumë larg nga ajo që shumica e njerëzve i konsiderojnë të vërteta ose të arsyeshme”. Pra “ekstremizmi” iu referohet qëndrimeve ose sjelljeve që konsiderohen jashtë normës.

Ekstremizmi i dhunshëm - iu referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që e mbështesin ose e përdorin dhunën për të arritur qëllimet ideologjike, fetare apo politike. Kjo përfshin terrorizmin dhe format e tjera të dhunës së motivuar politikisht apo edhe nga sektet e ndryshme.

Në mënyrë të veçantë, «ekstremizmi i dhunshëm» gjithashtu identifikon një armik ose armiqtë, të cilët janë objekt i urrejtjes dhe dhunës. Thelbi i konceptit të ekstremizmit të dhunshëm është se ai është një mjet i motivuar ideologjikisht për përdorimin e dhunës, zakonisht i bazuar në teoritë e konspiracionit.

2 Përkufizime lidhur me ekstremizmin dhe radikalizmin, të përdorura nga Organizata e Kombëve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën e Kulturën, (UNESCO).

Radikalizmi - Ashtu si me termin □ekstremizëm□, termi □radikalizëm□ diskutohet shumë kur përdoret në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm. Shqetësimi është se përdorimi i termit mund të shërbejë për të justifikuar kufizimet e lirisë së shprehjes. Në të vërtetë termi □radikal□ në kontekste të caktuara, thjesht ka kuptimin e asaj □që dëshiron të shkaktojë ndryshime politike”. Në kontekstin e përpjekjeve për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, “radikalizmi” zakonisht përdoret për të përshkruar proceset, gjatë të cilave personat me pikëpamje ekstreme arrijnë deri në atë pikë sa ta ligjërojnë përdorimin e dhunës. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, e datës 16 maj 2005, nuk e përcakton termin □radikalizëm□ por përmban përkufizimin për □provokim publik për kryerjen e veprës terroriste” në nenin 5, si: □shpërndarja, ose vënia në dispozicion, të një mesazhi për publikun, me qëllim për të nxitur kryerjen e një veprë terroriste, ku një sjellje e tillë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo përkrah veprat terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla mund të kryhen”. Konventa përcakton gjithashtu “rekrutimin për terrorizëm□ (Neni 6), si: “akt për t’i kërkuar një personi tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, ose për t’u bashkuar me një grup, me qëllim për të kontribuar në kryerjen e një apo më shumë veprave penale terroriste nga ana e këtij grupi “.

De-radikalizmi - Veprimtaritë e ndërmarra për ta ndryshuar mentalitetin e një individi të radikalizuar kundrejt pranimi ose miratimit të një ideologjie të dhunshme ekstreme, me qëllim që ta pengojë atë për të ndërmarrë veprime të dhunshme në të ardhmen.



● Kapitulli II



Roli i prindërve për të parandaluar ekstremizmin dhe radikalizmin

Prindërit janë faktorë të rëndësishëm për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit, por ndërkohë ata janë dhe partnerët më të mirë për deradikalizimin.

Prindërit duhet të jenë pjesë aktive e Komisionit të etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor; Bordit të institucionit arsimor; Këshillit të prindërve të institucionit arsimor dhe Këshillit të prindërve të klasës.

Si brenda, ashtu edhe jashtë këtyre organizmave, prindërit duhet të sigurojnë mbështetje për shkollën; bashkëpunim me aktorë të tjerë për zgjidhje konkrete të problematikave të ndryshme; bashkëpunim për parandalimin e shfaqjes së ekstremizmit dhe radikalizmit në shkollë, si dhe asistencë në ri-integrimin e nxënësve të radikalizuar.

Prindërit duhet të mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshme sjelljet e fëmijëve, vecanërisht cilët janë miqtë e tyre, sa kohë kalojnë në rrjetet sociale etj.; t'u krijojnë atyre një mjedis të qetë familjar; të respektojnë mendimet e tyre dhe të pranojnë debatin; të nxisin prirjet dhe talentin; t'i aktivizojnë në veprimtari sportive dhe kulturore; t'u qëndrojnë afër në orientimin e problematikave të moshës; të bisedojnë me ta për ekstremizmin, radikalizmin dhe rreziqet që vijnë prej tyre.

Prindërit duhet të bashkëpunojnë me shkollën për të adresuar ndryshimet në sjellje dhe problemet e fëmijëve duke u këshilluar me punonjësit arsimorë, drejtorin e shkollës apo me psikologun/punonjësin social për raste të veçanta.

Roli i prindërve dhe kujdestarëve nuk duhet nënvlerësuar, dhe praktika më e mirë do të ishte të punonin ngushtësisht me shkollat dhe faktorët e tjerë, për të mbrojtur fëmijët e tyre.

Komuniteti më i gjerë gjithashtu mund të jetë faktor mbrojtës. Për shembull, nëse fëmija është besimtar, atëherë krijimi i marrëdhënieve të ngushta me anëtarë të atij besimi, mund t'i devijojë ata nga versioni plot urrejtje dhe i diskredituar, i imponuar nga grupe si Al-Kaeda dhe ISIS.

Një alternativë tjetër, nëse nxënësit janë të interesuar për politikën, atëherë mund të inkurajohen ata t'i bashkohen Parlamentit rinor ose Këshillit të Rinjve për t'i bërë të vetëdijshëm mbi mënyrat si mund të ndikojnë mbi shoqërinë dhe t'i nxisin ndryshimet pozitive në mënyrë të sigurt dhe të dobishme.

Duhet marrë në konsideratë edhe komuniteti online. Ne kemi akses pothuajse të pakufizuar dhe të pafiltruar në materiale online që nxisin pikëpamjet ekstremiste. Ndonëse kompanitë e mëdha të teknologjisë janë bërë më të afta në zbulimin dhe heqjen e përmbajtjes së paligjshme ekstremiste, ka akoma një numër të madh mesazhesh online që shpërndahen dhe mbështeten nga këto organizata të ekstremizmit të dhunshëm/terrorizmit.

Kontrolli prindëror i internetit mund të jetë një nga mënyrat për të trajtuar se nga çfarë duhet të ruhet një fëmijë. Prindërit/kujdestarët mund edhe të venë kushte mbi vendin ku fëmija e tyre mund të përdorë internetin- për shembull në dhomën e përbashkët dhe jo në dhomën e tyre kur janë vetëm.

Gjithashtu, ata duhet të edukohen mbi sigurinë në internet, përfshirë kontrollin e fakteve dhe raportimin e shqetësimeve në lidhje me përmbajtjet online. Një fëmijë që është radikalizuar duhet të zhvillojë njohuritë kritike në mënyrë që të mos bjerë pre e propagandës.



● Kapitulli III



Çfarë duhet të dinë prindërit?

Profil radikal

Grupet ekstremiste tërheqin individët vulnerabël përmes propagandimit të pakënaqësisë kolektive/shoqërore për statusin e tyre social, sidomos përmes shprehjes së nevojave të tyre personale, duke izoluar ata nga shoqëria dhe nga familja, me qëllim nxitjen e fanatizmit ideologjik për t'i angazhuar në sjellje dhe veprime gjithnjë e më të dhunshme.

Këto mekanizma përdoren nga rekrutuesit për nxitjen e individëve me qëllim tejkalinin e pengesave psikologjike ndaj dhunës, për të kaluar nga vëzhgues të thjeshtë të dhunës, në pjesëmarrës aktivë në aktet e dhunshme. Pra, sjelljet e dhunshme janë sjellje të mësuara, të cilat përvetësohen brenda ambienteve sociale ku dhuna lejohet dhe nxitet njëkohësisht. Dhuna kundër armiqve justifikohet si e nevojshme nga grupet terroriste për një të mirë më të madhe të shoqërisë. Duhet të evidentojmë faktin se rrëfimet terroriste synojnë ta justifikojnë dhunën si të moralshme dhe të drejtë, si faktor i pranueshëm në shoqëri, dhe si një përgjigje ndaj armikut.

Theksojmë faktin që në ideologjinë ekstremiste synohet tejkalimi i pengesave psikologjike për përdorimin e dhunës nga ana e ndjekësve të tyre, me qëllim clirimin nga ndjenja e fajit për dëmtimin e të tjerëve. Ata përdorin një sërë metodash dhe mekanizmash të ndryshëm psikologjikë dhe moralë për reduktimin dhe eliminimin e ndjenjës së fajit që lidhet me dëmtimin e tjetrit.

Shenjat dhe qëndrimet e individëve shfaqen si më poshtë:

- Mban qëndrim kundër sistemit/institucioneve demokratike, shkollës, si dhe kundërshton sistematikisht ide të ndryshe nga të tija/të sajta.
- Mban qëndrim përjashtues dhe i konsideron përjashtues të tjerët që nuk mendojnë si ai/ajo.
- Mban qëndrim refuzues ndaj drejtimeve apo rrymave të ndryshme politike.

- Mbështet veprimtarinë e individëve të dënuar për akte terrorizmi brenda dhe jashtë vendit.
- Mban komunikim dhe mbështet shqiptarët që janë pjesë e grupit terrorist ISIS në Siri.
- Mbështet sulmet terroriste të kryera në Evropë dhe jo vetëm.

Cilët janë faktorët që tërheqin një nxënës/të ri drejt ideologjive ekstremiste

- Mund të kenë qenë duke kërkuar përgjigje në lidhje me çështjet e identitetit, besimit apo përkatësisë;
- Mund të tërhiqen nga dëshira për 'aventurë' apo entuziazëm;
- Mund të udhëhiqen nga nevoja për të rritur besimin në vete dhe për t'u promovuar dhe pranuar nga bashkëmoshatarët;
- Mund të tërhiqen nga një grup apo individë që ofrojnë mbështetje dhe pjesëmarrje në rrjete sociale;
- Mund të ndikohen nga ngjarjet që ndodhin në botë, që mund të rezonojnë me nevojën për të bërë një ndryshim.

Cilat janë shenjat e ekstremizmit tek fëmijët?

- Ndryshime të papritura dhe jashtë natyrës së fëmijës në veshje, në sjellje dhe në marrëdhëniet me moshatarët;
- Sjellje të dyshimta apo të fshehta;
- Humbja në mënyrë të papritur e interesit ndaj veprimtarive apo shokëve të mëparshëm;
- Shfaqja e interesit dhe simpatisë ndaj kauzave ekstremiste;
- Përkrashja dhe lavdërimi i akteve të dhunshme;
- Mbajtja dhe leximi i literaturës ekstremiste;
- Përdorimi i mesazheve të ngjashme me ato të organizatave ilegale terroriste apo ekstremiste.

Si mund t'i ruajmë fëmijët nga ekstremizmi dhe radikalizmi

Fëmijët sot rriten në epokën e informacionit. Me kaq shumë burime informacioni të disponueshme (por jo gjithnjë të sakta!) mund të jetë sfiduese për të rinjtë të orientohen në botën përreth tyre. Këto këshilla të thjeshta janë hartuar për të ndihmuar prindërit që të mendojnë për mënyrën më të mirë për t'i mbështetur fëmijët të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit për çështje që kanë rëndësi për ta. Duke ndjekur këtë udhëzues mund të ndihmoni fëmijën tuaj që të jetë i sigurt online dhe të zhvillojë aftësitë për të kuptuar dhe përzhedhur informacionin e besueshëm.

Përpjekja për të kuptuar çështjet aktuale, si çështje të ndjeshme dhe kontradiktore, është një aspekt kyç i edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve. Fëmijët janë të interesuar të kuptojnë shoqërinë dhe ndryshimet e saj, por ata kanë nevojë për mbështetje dhe udhëzime nga të rritur të cilët i besojnë dhe respektojnë.

Cilat janë disa nga çështjet:

Çështja #1: EMOCIONET

Çështjet politike dhe shoqërore krijojnë shpesh ndjenja e emocione të forta tek vetja jonë dhe komunitetet tona. Ne të gjithë kemi reagime emocionale ndaj ngjarjeve politike dhe shoqërore si dhe teknikave që përdor media për t'i raportuar këto ngjarje, që shpesh shërbejnë për t'i amplifikuar këto ndjenja dhe emocione. Kjo ngjall te fëmijët ndjesitë e inatit, ankthit ose entuziazmit.

Eshtë e rëndësishme t'i adresojmë këto emocione, pavarësisht se mund të jemi edhe vetë të përfshirë. Një veprim i parë i duhur për të filluar të mbështesni fëmijët në këtë proces është të kuptoni sesi ndihet për një çështje të caktuar. A ndihen ata konfuzë, kuriozë, të zemëruar etj.? (Shikoni udhëzuesin hap-pas-hapi për këshillat se si ta bëni këtë).

Çështja #2: PROVAT

Kur flisni me fëmijët tuaj është e rëndësishme ta filloni bisedën me ta nga gjërat që ata kuptojnë dhe janë të aftë të bëjnë.


Çfarë dinë, çfarë mendojnë apo kuptojnë ata për një çështje? Nuk është e rëndësishme që ju si prind të jeni specialist (shumë pak njerëz janë!). Është e rëndësishme të mbështesni fëmijët të mendojnë në mënyrë kritike për historitë që dëgjojnë dhe shohin. Kjo përfshin:

- Marrjen në konsideratë të pikëpamjeve të ndryshme për çdo çështje të dhënë.
- Kontrollin e burimeve të informacionit, p.sh. përqasja WWWDOT (shikoni linkët e dobishëm në seksion).
- Nxitjen që fëmijët tuaj të adoptojnë një qëndrim ku gjithmonë të venë në diskutim informacionin e marrë.

Mos prisni gjithnjë të gjeni përgjigjen perfekte. Disa çështje janë shumë të komplikua për të arritur ne përfundime të thjeshta dhe të qarta dhe ky është një mësim i rëndësishëm që fëmijët duhet ta dinë.

Çështja #3: FUQIZIMI

Shpesh shqetësohemi ose kemi ndjenja të fuqishme për çështje me rëndësi për shoqërinë, por mund gjithashtu të ndihemi të pafuqishëm dhe “jashtë-kontrollit”. Si të rritur duhet t'i ndihmojmë fëmijët të kuptojnë që mund të bëjnë diferencën në çështjet që u interesojnë. Kjo përfshin marrjen në konsideratë të pyetjeve të mëposhtme:



Këshilla për t'u marrë parasysh kur adresoni një çështje të diskutueshme.

Merrni në konsideratë hapat e mëposhtëm:

1. Adresoni më parë emocionet - ndjenjat.
2. Çfarë dimë ne? Çfarë provash ka?
3. Çfarë duam të bëjmë rreth kësaj?

Trajtimi i çështjes - Udhëzim hap pas hapi për veprimtari me fëmijët

Veprimtaria e parë. Zgjidhni një histori nga lajmet:

Mund të zgjidhni një histori që është me interes për të rinjtë, ose një që do të donit të diskutonit me ta.

Pyetini si ndiehen për historinë. Një mënyrë për ta bërë këtë është me Kartat e Emocionit, si më poshtë:

<i>Si iu bën të ndieheni kjo histori?</i>		
Konfuzë	Kuriozë	Të qetë
Të zemëruar	Me ankth	Indiferentë
Të interesuar	Të emocionuar	Diçka tjetër

Veprimtaria e dytë. Bëni kërkime mbi historinë së bashku:

Mund të jetë nga një burim që e kanë gjetur ata, ose nga një që e keni zgjedhur ju (ose me mirë akoma, të dy bashkërisht!)

Merrni në konsideratë këto pyetje kur kërkoni të dini për burimet:

- *Kush e ka shkruar informacionin? A është i besueshëm dhe çfarë provash ka?*
- *Kur u shkrua? Është i përditësuar informacioni?*
- *Pse u shkrua? A ka një agjendë? A është autori i njëanshëm?*
- *Ku tjetër mund të kontrolloni informacionin?*

Veprimtaria e tretë. Flisni për të:

Ndani çfarë keni gjetur dhe diskutoni reagimin tuaj ndaj saj.

Angazhimi në këtë proces (dhe të treguarit që je i përkushtuar) është i rëndësishëm.

A keni ndryshuar pikëpamjet tuaja mbi historinë? Si? Pse?

Merrni kohë për të diskutuar cilat duhet të jenë veprimet tuaja të ardhshme (Seksioni i Fuqizimit në faqe 2 mund të ofrojë disa ide fillestare që mund t'i shqyrtoni me fëmijën tuaj).

Qasje për të nxitur mendimin kritik të fëmijëve në lidhje me informacionin dhe lajmet apo faqet e internetit

Pyetje për t'u diskutuar:

1. **Kush** e ka shkruar dhe sa i besueshëm është?
2. **Përse** e ka shkruar?
3. **Kur** e ka shkruar?
4. A ju ndihmon në përmbushjen e nevojave tuaja?
5. **Po** organizimi i faqes së internetit si është?
6. **Rendisni** detyrat për të ardhmen.

Si mund t'i ndihmojnë prindërit fëmijët që ata të jenë të sigurtë?

- Të dini gjithmonë se ku dhe me kë është fëmija juaj duke e kontrolluar vetë.
- Të dini cilët janë shokët/ shoqet dhe familjet e tyre
- Mbani komunikim të hapur, dëgjojini dhe flisni me fëmijët për interesat e tyre.
- Nxitini të ndërmarrin dhe të organizojnë veprimtari me grupe, të cilave ju u besoni.
- Flisni me fëmijët rreth informacionit që shfaqet ne media, TV apo internet dhe shpjegojuni që ajo që duket nuk është pamja e plotë e asaj që në të vërtetë ndodh.
- Lejoni dhe nxisni debatin dhe pyetjet për ngjarjet që ndodhin në rajonin tuaj apo në botë, duke ndihmuar të kenë një këndvështrim t jetër.
- Inkurajoni fëmijët të tregojnë interes për komunitetin e zonës dhe të respektojnë besimet, prejardhjen apo statusin social të njerëzve të tjerë.

- Ndhimjini fëmijët të kuptojnë rrezikun e përfshirjes në një situatë për të cilën nuk ka informacion të plotë.
- Mësojuni fëmijëve që të shprehurit e pikëpamjeve me vendosmëri dhe përpjekja për të ndryshuar gjërat është një gjë e mirë, porse ata nuk duhet të ndërmarrin veprime të dhunshme kundër të tjerëve apo të mbështesin ata që kryejnë veprime të tilla.
- Bëni kujdes për veprimtarinë on-line të fëmijëve tuaj. Përditësoni njohuritë mbi zhvillimin e teknologjisë, vecanerisht medias online.
- Tregoni kujdes për median sociale që përdor fëmija juaj. Kujtojuni fëmijëve që personat që mund të lidhen në internet mund të prezantohen ndryshe apo t’ju tregojnë gjëra që nuk janë të vërteta.
- Shpjegojuni fëmijëve se nëse dikush ju kërkon të mbajnë sekrete ndaj prindërve, familjes apo mësuesve, me shumë mundësi po kërkon t’i dëmtojë apo t’i fusë në rrezik.

Çfarë duhet të bëjë prindi kur fëmija është i radikalizuar?

Kërko ndihmë!

- Njofto Policinë, nëse mendon apo dyshon që fëmija yt apo ndonjë fëmijë apo i ri tjetër është në rrezik për radikalizim.

Tel: 129

Kërko ndihmë per çdo emergjencë

Tel: 112

Shërbimi Social

Tel: 355 04 4 541 821 / +355 04 4 541 822

- Nëse jeni të shqetësuar apo dyshoni që fëmija juaj është influencuar nga të tjerë, kërkonin ndihmë, drejtohuni në shkollë dhe flisni me mësuesit. Gjithashtu mund të flisni me dike që i besoni: anëtar i familjes, kushëri, mik, udhëheqës fetar, o s e me shokë dhe shoqe të fëmijës suaj.
- Nëse ndjeni që ka rrezik që fëmija të largohet nga vendi, merrni masa për ta parandaluar largimin. Për shembull, duke i mbyllur pasaportën në një vend të sigurtë.

- Duhet të siguroheni që fëmija nuk mund të tërheqë para nga llogaria, kursimet tuaja apo të marrë si dhurata para në dorë– .

Si mund ta ndihmosh fëmijën tënd

Bëj!

- Mëso sigurinë në internet! Mund të kërkosh informacion apo të ndjekësh ndonjë kurs për t'u aftësuar personalisht për sigurinë në internet dhe përdorimin e tij.
- Kupto që përvojat e tua nuk janë domosdoshmërisht të ngjashme me ato të fëmijës tënd!
- Zhvillo aftësi për të treguar histori të kundërta nga ato që propagandojnë grupet terroriste!
- Flit ngadalë dhe me qetësi!
- Përpiqu të kuptosh përse fëmija përkrah këto ide dhe përse i shpalos?
- Kërko ndihmën e shokëve të tij/saj apo të rriturve të tjerë që ai/ajo respektojnë!
- Kërko ndihmën e mësuesve të shkollës që ndjek fëmija!
- Mba dokumentet, pasaportën e fëmijës në një vend të sigurt nëse dyshon që do të largohet.

Mos bëj!

- Mos u përpiq ta ndalosh të përdorë smartfone, telefon apo internet! Mospërdorimi nuk është zgjidhje afatgjatë. Ata do të kërkojnë mënyra të tjera për të rënë në kontakt.
- Mos krijë përshtypjen sikur “e ndjek” apo “e vëzhgon”!



Ky material është botuar në
kuadër të projektit
“Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit
të dhunshëm në shkolla dhe komunitete si mjet për
garantimin e të drejtave të fëmijëve”,
i financuar/mbështetur nga **UNICEF** dhe zbatuar nga
**Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm,
Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe Save the Children.**

@Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej
specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo
riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave,
të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht
pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children dhe UNICEF.



Tiranë, 2020